FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.40 17 prill 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.178, datë 11.3.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Kryeministrinë……	1717
Vendim i KM nr.180, datë 26.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.989, datë 9.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit të emergjencave civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmbytjet natyrore", të ndryshuar……	1717
Vendim i KM nr.183, datë 9.2.2011	Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit……	1718
Vendim i KM nr.186, datë 9.3.2011	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 22.11.2010, për çështjen nr.609/07 "Puto e të tjerë kundër Shqipërisë"……	1720
Vendim i KM nr.188, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Veli Rada….	1721
Vendim i KM nr.193, datë 9.3.2011	Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 400/220/110 kV, Tirana 2, në Kashar, Tiranë……	1721
Vendim i KM nr.194, datë 9.3.2011	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.325, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë"……	1724

Vendim i KM nr.195, datë 9.3.2011	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit dhe të truallit të ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Mirditë, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Shëndetësisë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.1292, datë 24.9.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit", të ndryshuar……	1729
Vendim i KM nr.197, datë 16.3.2011	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë……	1730
Vendim i KM nr.198, datë 16.3.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.634, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblit Popullor, të objektit nr.19 "Godina e sinoptikës së vjetër", pjesë e pronës nr.109 "Ish-uzina e artilerisë", me vendndodhje, Brarë, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes"……	1731
Vendim i KM nr.199, datë 16.3.2011	Për ngritjen e monumentit të Heroit të Demokracisë dhe Pluralizmit, Azem Hajdari, në parkun pranë ndërtesës së Parlamentit të ri, Tiranë……	1733
Vendim i KM nr.200, datë 2.3.2011	Për miratimin e planit të veprimit për fushën e organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ), 2011-2013……	1733
Vendim i KM nr.201, datë 16.3.2011	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës……	1735
Vendim i KM nr.207, datë 9.3.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Poliçan të qarkut të Beratit……	1740
Vendim i KM nr.208, datë 9.3.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Vllahinë të qarkut të Vlorës……	1741
Vendim i KM nr.210, datë 16.3.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kërrabë të qarkut të Tiranës……	1742
Vendim i KM nr.211, datë 16.3.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Sllovë të qarkut të Dibrës……	1743
Vendim i KM nr.212, datë 16.3.2011	Për disa shtesa dhe një ndryshim në vendimin nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar"……	1744

Vendim i KM nr.213, datë 16.3.2011	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës, tokë bujqësore, të ndodhur në ish-ndërmarrjen bujqësore, Spitallë, Durrës, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, për ndërtimin e një kampusi të ri universitar	1746
Vendim i ERE nr.22, datë 10.3.2011	Për pranimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të ERE-s nr.10, datë 18.2.2011.....	1746
Vendim i ERE nr.23, datë 10.3.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Vlushe" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	1748
Vendim i ERE nr.24, datë 10.3.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Vlushe" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1749
Vendim i ERE nr.25, datë 10.3.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Dragoshtunjë" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	1750
Vendim i ERE nr.26, datë 10.3.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Dragoshtunjë" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	1751
Vendim i ERE nr.27, datë 10.3.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Dunicë" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	1752
Vendim i ERE nr.28, datë 10.3.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Dunicë" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1753
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhiat Hoxha.....	1753

VENDIM
Nr.178, datë 11.3.2011

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR KRYEMINISTRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri "Shpenzime korrente", t'i shtohet fondi prej 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për shërbimet e kërkimit në fushën ligjore dhe lobizmit, të cilat do të shërbejnë për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të Republikës së Shqipërisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera, si dhe për identifikimin dhe tërheqjen e financimeve nga agjenci të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe agjenci të tjera ndërkombëtare e të investimeve në fusha me interes.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.180, datë 26.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.989, DATË 9.12.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË PËRBALLUAR SITUATËN E SHKAKTUAR NGA PËRMBYTJET NATYRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile" dhe në vijim të vendimit nr.968, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.989, datë 9.12.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në shkronjën "a" të pikës 1, fjalët … "shuma 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë…" zëvendësohet me "…shuma 696 407 923 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë…".

2. Fondi shtesë sipas këtij vendimi, në vlerën 196 407 923 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë, të akordohet për:

a) këshillin e qarkut Shkodër, në vlerën 28 500 000 (njëzet e tetë milionë e pesëqind mijë) lekë, për t'u përdorur për rikonstruksionin e rrugës së Obotit.

b) bashkinë Shkodër, në vlerën 117 907 923 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë, për t'u përdorur, si më poshtë vijon:

i) 63 672 979 (gjashtëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, për rehabilitimin e KUB-it dhe rikonstruksionin e rrugëve "Qemal Draçini" dhe "Martin Camaj".

ii) 31 234 944 (tridhjetë e një milionë e dyqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë për rehabilitimin e KUB-it dhe rikonstruksionin e rrugës "Europa".

iii) 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për rehabilitimin e stacionit të vjetër të pompave dhe të kabinës elektrike, në Dobraç.

iv) 8 000 000 (tetë milionë) lekë për rehabilitimin e stacionit në Bahçallëk.

c) Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për t'u përdorur për blerje mallrash industriale dhe ushqimore për fazën rehabilituese.

3. Efektet financiare të këtij vendimi, në vlerën 196 407 923 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë, të përballohen nga KESH sh.a. (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare).

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, këshilli i qarkut Shkodër dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.183, datë 9.2.2011

PËR KOMPENSIMIN PËR PRIVACIONET DHE HUMBJET QË I SHKAKTOHEN PUNONJËSIT TË POLICISË SË SHTETIT, PËR SHKAK TË NEVOJAVE TË PUNËS DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit të vet, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi, si më poshtë vijon:

a) Nga 36 km deri 60 km, në masën 3 000 lekë/muaj;

b) nga 61 km deri 100 km, në masën 5 000 lekë/muaj;

c) nga 101 km deri 150 km, në masën 8 000 lekë/muaj;

ç) nga 151 km deri 200 km, në masën 10 000 lekë/muaj;

d) mbi 200 km, në masën 15 000 lekë/muaj.

Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të policisë, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin e juridiksionit të komisariatit të policisë apo drejtorisë së policisë së qarkut (në rrethin qendër qarku), ku punonjësi i policisë është transferuar.

2. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, punonjësi i policisë paraqet në organin, ku është transferuar, dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesë me shkrim, me gjenealitetet e plota, ku përshkruhet:

- organi ku ka punuar;

- data e transferimit;
- motivi i transferimit;
- adresa ku banon aktualisht familja e tij;
- adresa ku banon përkohësisht vetë punonjësi.

b) Fotokopje të kartës së identitetit, certifikatë të gjendjes civile, personale dhe familjare.

c) vërtetim nga komuna/njësia bashkiake/bashkia, ku të vërtetohet vendbanimi i familjes dhe i vetë punonjësit të policisë, pavarësisht nga gjendja civile.

3. Kur punonjësi i policisë transferohet për nevoja pune dhe, për këtë shkak, bashkëshortja/i humbet marrëdhëniet e punës, në rast të pamundësisë së punësimit, i jepet një pagesë, deri në çastin e punësimit, në masën:

a) 50% të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ku bashkëshortja/i ka vjetërsi pune nga 3 muaj deri në 1 vit.

b) 100% të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 vit deri në 10 vjet.

c) 100% të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150% e pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi në punë mbi 10 vjet.

Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it indeksohet me rritjen e pagave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/it të punonjësit të policisë, deri në 15 vjet, në rastet kur në vendbanimin përkatës nuk ekzistojnë mundësi punësimi, llogaritet në vjetërsinë e përgjithshme të punës për efekt pensioni. Kontributi i sigurimeve derdhet nga institucioni dhe përfituesi sipas skemës së sigurimeve shoqërore për punonjësit civilë.

4. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, punonjësi i policisë paraqet në organin, ku është transferuar, dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesë me shkrim, me gjenealitetet e plota, ku përshkruhet:
- organi ku ka punuar;
- data e transferimit;
- arsyeja e transferimit;
- adresa ku ka banuar;
- adresa aktuale ku banon pas transferimit;
- qendra e punës ku ka punuar bashkëshortja/i, data dhe shkaku i largimit nga puna.

b) Librezën e punës të bashkëshortes/it, ku të jetë cilësuar largimi nga puna për arsye të transferimit të bashkëshortes/it.

c) Vërtetim nga zyra përkatëse e punësimit, ku të vërtetohet se bashkëshortja/i është regjistruar si punëkërkues i papunë dhe nuk i është ofruar punë në profesionin e saj/tij. Këtë vërtetim punonjësi e paraqet çdo tre muaj në zyrën e personelit.

5. Punonjësi i policisë, në përpjesëtim me kohën e shpenzuar gjatë ushtrimit të detyrës shtesë të trajnuesit në terren të punonjësve të policisë që kanë përfunduar periudhën e shkollimit në shkollën bazë të policisë, përfiton shtesë mbi pagën mujore në masën 40 lekë/orë, por jo më shumë se 7000 (shtatë mijë) lekë.

6. Përveç të drejtës për shpërblim në fund të vitit financiar, parashikuar në pikën 5 të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2010 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësit të Policisë së Shtetit, në kompensim të privacioneve dhe humbjeve që i krijohen për shkak të kryerjes së detyrave e shërbimeve të veçanta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit e të gatishmërisë, ruajtjen e administrimin e pronës dhe në ushtrimin e përgjegjësive të tjera të parashikuara me ligjin për Policinë e Shtetit, mund t’i jepet shpërblim deri në 1 (një) pagë mujore në vit. Ky shpërblim përballohet nga fondi i veçantë dhe mund të jepet përgjatë gjithë vitit kalendarik. Masa e shpërblimit përcaktohet dhe jepet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

7. Punonjësi i policisë, që përfiton sipas pikave 1 e 3 të këtij vendimi, nënkupton punonjësin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 11 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, duke mos përfshirë punonjësin e emëruar për herë të parë, por vetëm atë efektiv.

8. Vendimi nr.507, datë 18.7.2003 i Këshillit të Ministrave "Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Policisë së Shtetit.

10. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.186, datë 9.3.2011

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 22.11.2010, PËR ÇËSHTJEN NR.609/07 "PUTO E TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore", të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 22.11.2010, për çështjen nr.609/07 "Puto e të tjerë kundër Shqipërisë", në shumën 65 000 euro (gashtëdhjetë e pesë mijë) euro, plus çdo lloj tatimi që mund të jetë i zbatueshëm, si shpërblim financiar dhe jofinanciar, si dhe 2 000 (dy mijë) euro, plus çdo lloj tatimi që mund të jetë i zbatueshëm ndaj ankuesve, në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave.

3. Afati përfundimtar për kryerjen e ekzekutimit është data 14.3.2011.

4. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

5. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, z.Refat Puto, znj.Violeta Puto, znj.Saime Puto, z.Pandi Allabashi, znj.Ermira Allabashi dhe znj.Roza Allabashi, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

6. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 5 të këtij vendimi, në favor të ankuesve, z.Refat Puto, znj.Violeta Puto, znj.Saime Puto, z.Pandi Allabashi, znj.Ermira Allabashi dhe znj.Roza Allabashi, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.188, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHTESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z.VELI RADA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Veli Rada, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.193, datë 9.3.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/220/110 KV, TIRANA 2, NË KASHAR, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 400/220/110 kV, Tirana 2, në Kashar, Tiranë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të OST sh.a.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 6 059 (gjashtë mijë e pesëdhjetë e nëntë) m² tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 19 174 560 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekësh.
4. Fondi prej 19 174 560 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 361 000 (treqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohet nga OST sh.a., si subjekt kërkues i këtij shpronësimi.
6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit shkurt 2011 dhe të përfundojë brenda muajit gusht 2011.
7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.
8. Punimet për ndërtimin e nënstacionit 400/220/110 kV, Tirana 2, në Kashar, Tiranë, të përfundojnë brenda muajit gusht 2011.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OST sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE ME REFLEKTIMIN E NDRYSHIMEVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 400/220/110 KV “TIRANA 2”

Rrethi: Tiranë
Komuna: Kashar

Nr.	Objekti	Shpronësimi definitiv										Shpronësim provizor						
		Emri	**Atësia**	**Mbiemri**	**Lloji i pasurisë**	**Nr.kadastral**	**Nr. i pasurisë**	**Sasia e sip pronës m^2**	**Sasia shpronësim defintiv m^2**	**Çmimi shitje ZRPP lekë/m^2**	**Vlera e kompensimit**	**Sasia në m^2**	**Lloji i kulturës bujqësore**	**Vlera në lekë për/ha**	**Vlera në lekë për kulturën**	**Vlera totale e kompensimit në lekë**	**Adresa e pronarit**	**Ecuria e shpronësimit**
1	nst 400	Jemin	Ramazan	Hoxha	Pemëtore	2105	24/7/1	875	548	415	227,420					227,420	Kashar	Me certifikatë pronësie
2	nst 400	Sadik	Ramazan	Hoxha	Arë	2105	26/1	469	128	415	53,120					53,120	Kashar	Me certifikatë pronësie
3	nst 400	Sadik	Ramazan	Hoxha	Shtëpi	2105	26/11/2	1.8	1.8	58200	104,760					104,760	Kashar	Me certifikatë pronësie
4	nst 400	Sadik	Ramazan	Hoxha	Truall	2105	26/11/2	500	500	11000	5,500,000	500	Pemë		179,200	5,679,200	Kashar	Me certifikatë pronësie
5	nst 400	Njazi	Sadik	Hoxha	Shtëpi	2105	26/12	0.4	0.4	58200	23,280					23,280	Kashar	Me certifikatë pronësie
6	nst 400	Njazi	Sadik	Hoxha	Truall	2105	26/12	500	500	11000	5,500,000	500	Pemë		57,500	5,557,500	Kashar	Me certifikatë pronësie
7	nst 400	Rasim	Jemin	Hoxha	Shtëpi	2105	24/23	8.5	8.5	58200	494,700					494,700	Kashar	Me certifikatë pronësie
8	nst 400	Rasim	Jemin	Hoxha	Truall	2105	24/23	500	500	11000	5,500,000	500	Pemë		93,700	5,593,700	Kashar	Me certifikatë pronësie
9	nst 400	Pretendim pronësie			Arë	2105	119/2,3		3.272	415	1,357,880					1,357,880	Kashar	Po punohet nga Komuna Kashar për regjsitrimin e pronës
10	nst 400	Bajram	Mustafa	Sulaj	Arë	2105	24/28	379	431	415	12,969					12,969	Kashar	Me certifikatë pronësie
11	nst 400	Bajram	Mustafa	Sulaj	Arë	2105	24/26	1509	169	415	70,031					70,031	Kashar	Me certifikatë pronësie
Shuma									6.059							19,174,560	Kashar	
									6.059							19,174,560		

VENDIM
Nr.194, datë 9.3.2011

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.325, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PRANIMIN NË VEPRIMTARINË E OPERATORIT TË TRANSPORTIT RRUGOR TË MALLRAVE DHE TË UDHËTARËVE, SI DHE PËR NJOHJEN E DOKUMENTEVE ZYRTARE, TË CAKTUARA PËR KËTA OPERATORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 8 e 43 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, dhe të neneve 83 e 87 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit nr.325, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vlerat monetare që tregojnë gjendjen e përshtatshme financiare të një ndërmarrjeje transportit të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 5.2 të kapitullit II të rregullores, hyn në fuqi nga data 1 janar 2012.
3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PRANIMIN NË VEPRIMTARINË E OPERATORIT TË TRANSPORTIT RRUGOR TË MALLRAVE DHE UDHËTARËVE, SI DHE NJOHJA E DOKUMENTEVE ZYRTARE TË CAKTUAR PËR KËTA OPERATORË"[1]

I. Në kapitullin I bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
1. Shkronja "c" e pikës 1.2 shfuqizohet.
2. Pas pikës 1.2 shtohet pika 1.3 me përmbajtje si më poshtë:

"1.3 Dispozitat e këtij vendimi, për sa i përket kërkesës për kompetencën profesionale sipas shkronjës "c" të pikës 1 të kapitullit II, nuk do të zbatohen për ndërmarrjet e transportit që përfshihen në:

a) veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, ndërkombëtar dhe brenda vendit, me mjete motorike ose kombinimi të mjeteve, kur ngarkesa maksimale e lejuar është deri në 3.5 tonë;

b) veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave për të tretë ose me qira brenda vendit, që operojnë me jo më shumë se 1 mjet, i cili kryen udhëtim në një distancë me një rreze udhëtimi jo më të madhe se 10 km; dhe

[1] Celex (EC) 32009R1071 rregullore e Parlamentit Europian dhe Këshillit, e 21 tetorit 2009 "Vendosja e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen në veprimtarinë e transportit rrugor dhe shfuqizimi i direktivës së këshillit 96/26/EC"

c) veprimtarinë e transportit rrugor për shërbimet e rregullta në transportin e udhëtarëve për linjat rrethqytetëse, ku ndërmarrja e transportit zotëron jo më shumë se 1 mjet.".

3. Pas shkronjës "b" të pikës 2.3 shtohet shkronja "c" me përmbajtjen si më poshtë:

"c) ndërmarrjet në veprimtarinë e transportit rrugor të udhëtarëve në shërbimin taksi, i cili rregullohet sipas nenit 35 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998.".

II. Në pikat 3.3, 3.5, 5.5, 8.3 dhe 8.4 të kapitullit II, togfjalëshi "organet e transportit" dhe "organet e transportit të licencimit" zëvendësohet me togfjalëshin "organet e transportit dhe ose QKL-ja".

III. Në kapitullin II bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 2 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

"2. Drejtuesi i veprimtarisë së transportit

2.1 Një ndërmarrje, e cila përfshihet në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor cakton të paktën një person fizik, drejtues i veprimtarisë, i cili kënaq kërkesat e vendosura në shkronjat "a" dhe "c" të pikës 1 të këtij kapitulli, si dhe:

a) drejton efektivisht dhe vazhdimisht veprimtarinë e transportit të ndërmarrjes;

b) ka një pozicion të tillë në ndërmarrje siç mund të jetë një punonjës, drejtor, pronar ose aksionar ose administrator i saj, ose kur ndërmarrja është një person fizik, është vetë ky person;

c) ka vendqëndrimin në Shqipëri.

2.2 Nëse një ndërmarrje transporti nuk plotëson kërkesën e kompetencës profesionale të parashikuar në shkronjën "c" të pikës 1, organi i transportit ose QKL-ja e autorizon atë të përfshihet në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor pa një drejtues veprimtarie sipas pikës 2.1 të këtij kapitulli, me kusht që:

a) ndërmarrja cakton një person fizik, me vendqëndrim në Shqipëri, i cili kënaq kërkesat e shkronjave "a" dhe "c" të pikës 1, dhe emërohet në bazë të një kontrate në kryerjen e detyrimeve si drejtues veprimtarie në emër të ndërmarrjes;

b) kontrata, që lidh ndërmarrja me personin e përmendur në shkronjën "a" të pikës 2.2 të këtij kapitulli, specifikon detyrat që kryhen mbi baza të efektivitetit dhe vazhdimësisë së këtij personi, dhe tregon përgjegjësitë e tij si drejtues veprimtarie. Detyrat në veçanti përmbajnë:

i) mirëmbajtjen e mjeteve;

ii) verifikimin e kontratave dhe dokumenteve të transportit rrugor;

iii) veprimet financiare bazë;

iv) caktimin e ngarkesave ose shërbimeve të drejtuesve dhe mjeteve; dhe

v) verifikimin e procedurave të sigurisë;

c) me aftësinë e tij si drejtues veprimtarie, personi i përmendur sipas shkronjës "a" të kësaj pike lejohet të drejtojë veprimtarinë e transportit deri në tri ndërmarrje të ndryshme të vendosura në të njëjtin rreth me një numër të përgjithshëm maksimal të mjeteve motorike dhe, ose kombinimit të mjeteve, prej 36 mjetesh.

ç) personi i përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike kryen detyra të specifikuara vetëm për interesat e ndërmarrjes dhe përgjegjësitë e tij ushtrohen në mënyrë të pavarur për cilindo prej ndërmarrjeve për të cilën zbaton operacionet e transportit.

2.3 Drejtuesi i veprimtarisë i caktuar në përputhje me pikën 2.1 të këtij kapitulli mund të caktohet në përputhje me shkronjën "c" të pikës 2.2 të këtij kapitulli edhe në një ndërmarrje ose filial tjetër, përveç asaj të përmendur në pikën 2.1 të këtij kapitulli, me seli brenda të njëjtit rreth me një numër të përgjithshëm maksimal, të mjeteve motorike, dhe ose kombinimit të mjeteve, prej 36 mjetesh.

2.4 Ndërmarrja për, ose e përfshirë në veprimtarinë e transportit rrugor njofton, respektivisht, organin e transportit ose QKL-në për drejtuesin/drejtuesit e caktuar të veprimtarisë. Njoftimi për çdo ndryshim të drejtuesit ose drejtuesve të veprimtarisë bëhet brenda 30 ditëve në organin përkatës të lëshimit të licencës.

2.5 Personat që punojnë në organet e transportit ose të varësisë ose në QKL, ose në organet e kontrollit në rrugë sipas nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, e që mbulojnë veprimtarinë e transportit rrugor, dhe që janë të pajisur me certifikatën e kompetencës profesionale nuk lejohen të

ushtrojnë veprimtarinë e tyre si drejtues veprimtarie në ndërmarrje të transportit rrugor. Shkelja e këtij rregulli përbën shkelje të reputacionit të drejtuesit të veprimtarisë dhe shkak për heqjen e certifikatës së kompetencës profesionale.".

2. Fjalia hyrëse e shkronjës "a" të pikës 3.1 riformulohet si më poshtë:

"a) Drejtuesi/drejtuesit i veprimtarisë ose ndërmarrja provojnë se nuk kanë kryer shkelje ose dënim në lidhje me:"

3. Nënpika "viii" e shkronjës "a" të pikës 3.1 shfuqizohet.

4. Pas nënpikës "xi" të shkronjës "a" të pikës 3.1 shtohen nënpikat me përmbajtje si më poshtë:

xii) të drejtën tregtare;

xiii) paaftësinë financiare për të vepruar sipas ligjit;

xiv) kushtet e pagesës dhe të punësimit në profesion;

xv) trafikimin e qenieve njerëzore apo drogës.

5. Pas shkronjës "ç" të pikës 3.1 shtohet shkronja "d" me përmbajtjen si më poshtë:

"d) ka kryer sigurimin e detyrueshëm për dëmin ndaj palëve të treta në transport.".

6. Pikat 5.1, 5.2 dhe 5.3 rifomulohen me përmbajtje si më poshtë:

"5.1 Një kandidat për, ose mbajtës i një licence operatori në transportin rrugor, me qëllim plotësimin e shkronjës "b" të pikës 1 të këtij kapitulli duhet të jetë i aftë të plotësojë detyrimet financiare për çdo vit financiar. Gjendja e përshtatshme financiare, për çdo vit financiar provohet në bazë të auditimit ligjor të kryer nga ekspertë kontabël të regjistruar apo kontabilistë të miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.2 Një kandidat për, ose mbajtës i një licence operatori në transportin rrugor që autorizon përdorimin e mjeteve nuk konsiderohet në gjendje financiare të përshtatshme, përveç rastit kur, në bazë të analizës financiare të demonstruar sipas pikës 5.1 të këtij kapitulli, ka në dispozicion të tij kapital dhe rezerva të një shume të barabartë me ose që tejkalon shumën e përgjithshme.

a) 5600 euro për mjetin e parë dhe 3500 euro për çdo mjet shtesë të përdorur, kur kryen transport ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;

b) 60 000 lekë për mjetin e parë dhe 30 000 lekë për çdo mjet shtesë të përdorur, kur kryen transport të mallrave dhe të udhëtarëve brenda vendit.".

5.3 Si përjashtim nga pikat 5.1 dhe 5.2, organet e transportit dhe ose QKL-ja lejohet të pranojnë që një kandidat për, ose mbajtës i një licence operatori në transportin rrugor të provojë gjendjen e përshtatshme financiare të tij, me anë të një vërtetimi që mund të jetë një garanci bankare, ose një siguracion, përfshirë një siguracion të përgjegjësisë profesionale nga një ose më shumë banka ose institucione të tjera financiare, përfshirë shoqëritë e sigurimit, të cilat bëhen garant solidar për ndërmarrjen lidhur me shumat e përcaktuara në pikën 5.2 të këtij kapitulli.".

7. Në pikën 5.4 togfjalëshi "pesë vjet" zëvendësohet me "tetë vjet".

8. Në fjalinë e parë të pikës 6.1 togfjalëshi "në përputhje me pikën 2.1 të kapitullit II" riformulohet si vijon: "në përputhje me pikat 2.1 dhe 2.2 të këtij kapitulli".

9. Pika 6.2 riformulohet si më poshtë:

"6.2 Dokumentin e kompetencës profesionale për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave ose udhëtarëve mund ta përftojnë vetëm kandidatët, që kanë mbaruar të paktën arsimin e mesëm dhe kanë një eksperiencë pune si administrator ose drejtor për një periudhë trevjeçare, pa ndërprerje në një ndërmarrje të transportit rrugor ndërkombëtar ose të brendshëm para datës së aplikimit.

6.2.1 Dokumentin e kompetencës profesionale në transportin e brendshëm rrugor për mallra ose udhëtarë mund ta përftojnë kandidatët, që kanë mbaruar arsimin e mesëm.

6.2.2 Eksperienca nuk është e nevojshme për kandidatët që kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në institucionet e arsimit të lartë me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 8.1.

6.2.3 Për personat e përmendur në pikat 6.2, 6.2.1 dhe 6.2.2 të këtij kapitulli, kursi i trajnimit është i detyrueshëm dhe më pas ata i nënshtrohen një provimi me shkrim dhe me gojë në përputhje me pikën 7 të këtij kapitulli.".

10. Fjalia e dytë e pikës 6.4 riformulohet si më poshtë:

“Kriteret që duhet të përmbushin qendra dhe instruktorët e trajnimit për funksionimin e saj, si dhe verifikimi në vazhdimësi në përmbushjen e këtyre kritereve, caktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin.”.

11. Pas pikës 6.4 shtohen pikat 6.5 dhe 6.6 me përmbajtjen si më poshtë:

“6.5 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me qëllim përditësimin e njohurive në fushën e transportit të drejtuesit e veprimtarisë, organizon trajnimin e reduktuar pasi janë plotësuar 5 vjet nga lëshimi i certifikatës së kompetencës profesionale, si dhe harton programe të veçanta që burojnë nga programi bazë, të cilat i miraton ministri përgjegjës për transportin. Kandidati duhet të aplikojë të paktën 3 muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ÇKP-së. Tarifa për këtë trajnim caktohet në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe Ministrit të Financave.

6.6 Nëse një mbajtës i një ÇKP-je nuk ka drejtuar një ndërmarrje transporti për tri vitet e fundit pa ndërprerje, ai duhet të përditësojë njohuritë e tij duke kryer një ritrajnim sipas pikës 6.5. Pagesa për këtë përditësim njohurish caktohet në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe Ministrit të Financave.”.

12. Pika 7.2 riformulohet si më poshtë:

“7.2 Komisioni emërohet nga ministri përgjegjës për transportin dhe përbëhet nga kryetari, i cili përfaqëson një person me integritet të lartë moral e profesional, veçanërisht në fushën e transportit, si dhe dy anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, që mbulon çështjet e transportit, dhe tjetri, përfaqësues i shoqatave të transportit rrugor. Anëtarët e komisionit duhet të jenë të pajisur me diploma të shkollave të larta të përmendura në pikën 8.1.”.

13. Fjalia e dytë e pikës 8.1 zëvendësohet me fjalinë me përmbajtjen si më poshtë:

“Me përjashtim të kandidatëve të diplomuar në edukimet e përmendura në këtë pikë, të cilët përjashtohen nga trajnimi dhe provimi i detyrueshëm për pjesën që janë diplomuar, të gjithë kandidatët e tjerë, pa përjashtim, duhet të kryejnë kursin e trajnimit dhe t’u nënshtrohen provimit me shkrim dhe me gojë sipas pikës 7.”.

14. Pika 8.2 riformulohet si më poshtë:

“8.2 Nëpunësit civilë të politikave të transportit rrugor, të sigurisë dhe qarkullimit rrugor, të lëshimit të licencave dhe, ose autorizimeve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, drejtuesit e Policisë Rrugore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe qarqe, drejtuesit e DPSHTRR-së në qendër dhe qarqe dhe punonjësit e transportit në Institutin e Transportit, të cilët kanë ushtruar këto detyra mbi 3 vjet përjashtohen nga detyrimi për trajnimin dhe provimi në përfitimin e certifikatës së kompetencës profesionale.”.

15. Në pikën 8.3 grupi “dhe 7.2” hiqet.

IV. Në kapitullin III bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1.1 riformulohet si më poshtë:

“1.1 Organet e transportit dhe QKL-ja ushtrojnë funksionin e tyre, respektivisht në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ligjit 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, dispozitave të këtij vendimi e dispozitave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta.”.

2. Pika 2.3 riformulohet si më poshtë:

“2.3 Koha maksimale e lejuar për shqyrtimin e një kërkese për licencë të lëshuar nga organet e transportit dhe QKL-ja është respektivisht në përputhje me ligjin nr.8308, datë 18.3.1998, si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3A, 3B, 3C dhe 3Ç me emërtimin dhe përmbajtjen e mëposhtme:

“3A Kontrollet

3A.1 Organet e transportit dhe, ose në bashkëpunim me organet e kontrollit të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” kontrollojnë

ndërmarrjet, të cilat janë të licencuara në veprimtarinë e transportit rrugor, nëse ato plotësojnë në vazhdimësi kërkesat e pikës 1 të kapitullit II.

3A.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është institucioni përgjegjës, i cili planifikon dhe organizon kontrollet me organet e tjera të kontrollit.

3A.3 Deri më 31 dhjetor 2018, organet e kontrollit do të kryejnë kontrolle të paktën çdo pesë vjet për të verifikuar që ndërmarrjet e transportit plotësojnë kërkesat e pikës 1 të kapitullit II.

3B Pezullimi dhe heqja e licencës nga organi që ka lëshuar licencën

3B.1 Në bazë të shkronjës "c" të nenit 6 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, kur organi i transportit vërteton që një ndërmarrje e licencuar prej tij rrezikon në plotësimin e kërkesave të nenit 6 të këtij ligji ose pikës 1 të kapitullit II të rregullores, ai duhet të njoftojë zyrtarisht personin përgjegjës ose drejtuesin e veprimtarisë së ndërmarrjes për këtë. Nëse organi i transportit vëren se një ose më shumë prej kërkesave nuk plotësohet në vazhdimësi, me qëllim rregullimin e situatës, ai i jep ndërmarrjes mundësi të kufizuara kohore si vijon:

a) një periudhë kohore deri në 9 muaj për marrjen në punë të një drejtuesi zëvendësues veprimtarie, në rastin kur mbajtësi i licencës mbështet te një drejtues veprimtarie, i cili:

i) vdes;

ii) ndërpret veprimtarinë për arsye të paaftësisë fizike ose mendore, për të qenë i aftë në kryerjen e detyrave të tij;

iii) ndërpret veprimtarinë për arsye të tjera;

iv) nuk plotëson më tej kërkesën e reputacionit të mirë; ose

v) nuk plotëson më tej kërkesën e kompetencën profesionale.

b) Në rastin kur mbajtësi i licencës është një ndërmarrje transporti me dy ose më shumë drejtues veprimtarie, dhe ndonjëri prej këtyre drejtuesve humbet reputacionin e mirë, organi i transportit i kërkon mbajtësit të licencës (ndërmarrjes) brenda periudhës së përmendur më sipër, heqjen e këtij drejtuesi të veprimtarisë dhe caktimin e një drejtuesi tjetër në vend të tij.

c) Një periudhë kohore deri në 12 muaj, kur kërkesa e qëndrueshmërisë financiare nuk plotësohet, me qëllim demonstrimi që kjo kërkesë do të plotësohet përsëri në baza të qëndrueshme.

3B.2 Licenca hiqet kur ndërmarrja e transportit nuk fillon veprimtarinë e saj brenda afatit të vendosur në të nga organi i transportit. Afati i fillimit të veprimtarisë nuk duhet të jetë më i gjatë se 3 muaj nga dita e lëshimit të licencës.

3C Procedurat për pezullimin ose heqjen e licencës ose certifikatës

3C.1 Kur organi i transportit vendos për pezullimin ose heqjen e një licence, respektivisht sipas pikës 3B.1 të këtij kapitulli:

a) ai njofton mbajtësin e licencës për vendimin dhe arsyet për të cilat ai ka marrë këtë vendim;

b) pezullimi ose heqja e licencës hyn në fuqi në fund të periudhës 21-ditore, duke filluar me ditën, që njoftimi i është dhënë mbajtësit të licencës.

3 C.2 Një licencë do të qëndrojë e pezulluar derisa organi i transportit të njoftojë hyrjen përsëri në fuqi të saj.

3 C.3 Mbajtësi i një licence mund të ankimojnë kundër një vendimi për pezullimin ose heqjen e një licence te titullari i organit të transportit brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e pezullimit ose heqjes së licencës.

3 Ç Dorëzimi i licencës dhe certifikatës së mjetit

3 Ç.1 Mbajtësi i një licence dorëzon licencën së bashku me certifikatat e mjeteve tek organi i transportit, i cili e ka lëshuar atë, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë ose heqjes së licencës brenda 7 ditëve, pas ditës në të cilën përfundimi i vlefshmërisë ose heqja ka hyrë në fuqi.

3 Ç.2 Pronari i një mjeti dorëzon certifikatën e mjetit tek organi i transportit, i cili e ka lëshuar atë pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë ose heqjes brenda 7 ditëve, pas ditës në të cilën përfundimi i vlefshmërisë ose heqja ka hyrë në fuqi.

3 Ç.3 Për pezullimin e një licence operatori ose certifikate të mjetit sipas kësaj rregulloreje, organi i transportit njofton me shkrim mbajtësin e licencës ose pronarin e mjetit që të dorëzojë këto dokumente tek ai brenda 7 ditëve, pas ditës në të cilën është dorëzuar njoftimi te personi.

3Ç.4 Nëse një subjekt nuk dorëzon në organin e transportit përkatës, brenda afatit të përmendur në pikat e mësipërme, licencën dhe, ose certifikatën e pezulluar ose të hequr, ky i fundit njofton organet përgjegjëse të kontrollit në rrugë dhe të gjitha organet e tjera të interesuara për ndalimin në ushtrimin e veprimtarisë së këtij operatori të transportit rrugor.".

5. Fjalia e dytë e pikës 4.1, shfuqizohet.

6. Në pikën 4.2, treguesi "5.1", zëvendësohet me treguesin "4.1".

7. Pika 4.3 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

"4.3 Organet e transportit, në përputhje me ligjin nr.8308, datë 18.3.1998, marrin vendime që përfshijnë refuzimin e një aplikimi, pezullimin ose heqjen e një licence ekzistuese dhe deklarimin e papërshtatshëm të drejtuesit të veprimtarisë. Për çdo vendim të marrë, ato janë të detyruar të arsyetojnë shkaqet mbi të cilën ato janë bazuar.".

VI. Pas kapitullit V shtohet aneksi 1 me përmbajtje si më poshtë:

"ANEKSI 1

Për qëllime të kësaj rregulloreje do të përdoret përkufizimi si vijon:

"Drejtuesi i veprimtarisë së transportit" nënkupton një person fizik të punësuar nga një ndërmarrje ose, kur kjo ndërmarrje është një person fizik, mund të jetë vetë personi fizik ose një person tjetër i caktuar prej tij me anën e një kontrate, i cili drejton efektivisht dhe në vazhdimësi veprimtaritë e transportit të ndërmarrjes." (Pika IV, QKL).

VENDIM
Nr.195, datë 9.3.2011

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT DHE TË TRUALLIT TË NDËRTESËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR, MIRDITË, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE MINISTRIA E SHËNDETËSISË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1292, DATË 24.9.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË APELIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit dhe të truallit të ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Mirditë, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Shëndetësisë, për Drejtorinë e Shëndetit Publik, Mirditë.

2. Administrimi i kësaj prone të paluajtshme bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në Kodin Civil, duke mos ndryshuar destinacionin e saj.

3. Nënndarja "vii" e pikës 1 të vendimit nr.1292, datë 24.9.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.197, datë 16.3.2011

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë, të 5 (pesë) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
2. Misioni është planizimi, monitorimi, komandimi dhe kontrolli i aktivitetit operacional të seksioneve dhe njësive të KFOR-it.
3. Kohëzgjatja e misionit është deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj, me venddislokim në Prishtinë, Kosovë.
4. Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Tiranë-Prishtinë dhe anasjellas është përgjegjësi e palës shqiptare.
5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet, si më poshtë vijon, për:
a) shpërblimin që do të marrin këta ushtarakë për vështirësi shërbimi, në masën 4000 (katër mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
b) siguracion jete;
c) akomodim;
ç) ushqim;
d) laventeri;
dh) shpenzime ndërlidhjeje emergjente;
e) trajtim mjekësor;
ë) mbështetje shëndetësore;
f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.
6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.198, datë 16.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.634, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS DHE BALETIT E ANSAMBLIT POPULLOR, TË OBJEKTIT NR.19 "GODINA E SINOPTIKËS SË VJETËR", PJESË E PRONËS NR.109 "ISH-UZINA E ARTILERISË", ME VENDNDODHJE, BRARË, TIRANË, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.634, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, fjalët "… nr.19 "Godinë e Sinoptikës së Vjetër"…" zëvendësohen me "… me sipërfaqe 1031.63 m^2… ".

2. Në pikën 1 fjalët "… nr.19 "Godinë e Sinoptikës së Vjetër", me sipërfaqe 980.4 (nëntëqind e tetëdhjetë pikë katër) m^2…" zëvendësohen me "… me sipërfaqe 1031.63 (një mijë e tridhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e tre) m^2, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi …".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.199, datë 16.3.2011

PËR NGRITJEN E MONUMENTIT TË HEROIT TË DEMOKRACISË DHE PLURALIZMIT, AZEM HAJDARI, NË PARKUN PRANË NDËRTESËS SË PARLAMENTIT TË RI, TIRANË

Në mbështetje të neneve 95 pika 2, e 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Monumentit të Heroit të Demokracisë dhe Pluralizmit, Azem Hajdari, në parkun midis godinës së Kryeministrisë dhe lumit Lana, me shikim nga bulevardi "Dëshmorët e Kombit", pranë ndërtesës së parlamentit të ri.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit, për vitin 2011, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Vendimi nr.584, datë 23.6.2006 i Këshillit të Ministrave "Për ngritjen e Monumentit të Heroit të Demokracisë, Azem Hajdari, në qytetin e Tiranës", shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.200, datë 2.3.2011

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR FUSHËN E ORGANIZMAVE TË MODIFIKUAR GJENETIKISHT (OMGJ), 2011-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për fushën e organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ), që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministritë e linjës, të përmendura në tekstin e planit të veprimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI I VEPRIMIT
PËR FUSHËN E ORGANIZMAVE TË MODIFIKUAR GJENETIKISHT (OMGJ), 2011-2013
(Sipas institucioneve, me qëllim përafrimin e legjislacionit me Acquis-në e BE-së)

	Masa e parashikuar	Përshkrimi i aktivitetit/masës	Afati kohor	Institucioni përgjegjës
1	**Njohja me përmbajtjen e legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve**			
	1.1 Njohja me përmbajtjen e legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve	1.1.1 Identifikimi i listës së legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve për përafrim	2011	MIE/institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.2 Përcaktimi i numrit të faqeve të legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve me qëllim përkthimin, përditësimi i listës ekzistuese me aktet në fuqi të BE-së	2011 e në vazhdim	MIE/institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.3 Paraqitja në MIE e kërkesave për përkthim	shkurt 2011	Institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.4 Përkthimi i direktivave dhe rregulloreve të BE-së që lidhen me fushën e OMGJ-ve	2011	MIE
		1.1.5 Hartimi i planeve të trajnimit nga çdo institucion	shtator 2011	Institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.6 Trajnimi i stafik teknik mbi vendimin e Këshillit të Ministrave nr.201, datë 29.3.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave"	prill 2011	Të gjitha palët e interesit
		1.1.7 Seminar prezantues mbi aktet kuadër të BE-së në fushën e OMGJ-ve	maj 2011	Institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
2.	**Analiza mbi detyrat që dalin për përafrimin e kuadrit ligjor europian**			
	2.1 Rishikimi i përgjegjësive institucionale për fushën e OMGJ-ve, në përputhje me tagrat institucionale dhe detyrimi për përafrim të legjislacionit	2.1.1 Aktivizim i GNP për kapitullin e acquis që trajton OMGJ-të	2011	MBUMK, MMPAU, MSH, MASH, METE, MIE
		2.1.2 Rishikimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.179, datë 22.2.2006 "Për krijimin e njësive të integrimit europian në ministritë e linjës", dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.201, datë 29.3.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave"	shkurt-mars 2011	
3.	**Masat për veprim me qëllim përafrimin e legjislacionit për fushën e OMGJ-ve**			
	3.1 Amendime të legjislacionit kuadër	3.1.1 Ligji për ushqimin	shtator 2011-prill 2013	MBUMK, MMPAU, MSH, MASH, METE, MIE, MD
		3.1.2 Ligji për mjedisin		
		3.1.3 Ligji për arsimin		
		3.1.4 Ligji për shëndetin publik		
		3.1.5 Ligji për mbrojtjen e konsumatorit		
	3.2 Hartimi i akteve të reja ligjore e nënligjore	3.2.1 Përgatitja e matricës	shkurt 2011-dhjetor 2012	MBUMK, MMPAU, MSH, MASH, METE, MIE, MD
		3.2.2 Miratimi i matricës		

VENDIM
Nr.201, datë 16.3.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Neni 1
Parimet e veprimtarisë së Këshillit

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe në parimet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

Neni 2
Përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit

1. Përzgjedhja për anëtarin e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës përfaqësues i shoqërisë civile, bëhet një herë në katër vjet nga ministri që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës, në përfundim të një procedure konkurrimi të hapur, mbështetur në kritere që vlerësojnë angazhimin e tij/saj në çështjet e të drejtave të fëmijës.
2. Përfaqësuesit/et e qeverisë, të shoqërisë civile në Këshill emërohen sipas procedurës së përcaktuar në urdhrin e Kryeministrit për krijimin e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Neni 3
Mandati i anëtarëve të Këshillit

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.
2. Mandati i anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës fillon me emërimin e tij/saj, nga ministri/ja që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës.

3. Nëse anëtari/ja i/e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka plotësuar mandatin e parë prej 4 vjetësh, ministri/ja që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës, i drejton një kërkesë drejtuesit/es të/së ministrisë në të cilën kërkon rikonfirmimin e një mandati të dytë për të. Ministri/ja që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës, bën riemërimin ose emërimin me një mandat të ri të anëtarit/es të/së Këshillit.

4. Ministri/ja që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës, gjatë procedurës së ripërtëritjes së mandateve, bën kujdes të shmangë ripërtëritjen në të njëjtën kohë të të gjitha mandateve të anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Nëse vërtetohen situata të tilla, atëherë përfaqësuesit e shoqërisë civile do të jenë anëtarët e Këshillit, të cilët do të rifitojnë drejtpërdrejt një mandat të ri.

5. Anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës i ndërpritet mandati 4-vjeçar, nëse lirohet nga detyra, për shkak të së cilës ai/ajo është anëtar/e i/e Këshillit.

6. Nëse anëtarit/es, përfaqësues i shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës i ndërpritet mandati 4-vjeçar, për shkak të lirimit nga detyra, shoqëria civile do t'i nënshtrohet procedurës, sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Përfundimi i mandatit i anëtarëve të Këshillit

Mandati i anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës përfundon:

a) me plotësimin e afatit 4-vjeçar, nëse nuk është ripropozuar për një mandat të ri;

b) pas lirimit nga detyra, për shkak të së cilës është emëruar anëtare i/e Këshillit;

c) me dorëheqjen e vetë anëtarit/es së Këshillit, për të cilën duhet të njoftojë me shkrim një javë përpara organin që e ka propozuar;

ç) për shkaqe shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen e tij/saj për më shumë se dy mbledhje në vit;

d) me vdekjen e tij/saj.

Neni 5

Kryetari/ja i/e Këshillit

1. Kryetar/e i/e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është ministri/ja që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës.

2. Kryetari/ja i/e Këshillit drejton mbledhjen e tij, diskutimet në të, siguron zbatimin e dispozitave të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

3. Kryetari/ja e Këshillit mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet:

a) kur në mbledhjen e Këshillit mungon kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve të tij;

b) kur ka dyshime të arsyeshme se për marrjen e një vendimi nevojiten fakte apo të dhëna të mbledhura nga organe të tjera shtetërore, si dhe;

c) e situatave të tensionuara apo konfliktuale midis anëtarëve të Këshillit, të cilat e përligjin një veprim të tillë.

4. Kryetari/ja e Këshillit në këto raste duhet të marrë një vendim të arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 6

Pjesëmarrës të ftuar në mbledhjet e Këshillit

1. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës mund të ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote:

a) drejtuesi/ja i/e strukturës politikbërëse për çështjet e të drejtave të fëmijës në ministri;

b) përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që merren me çështjet e të drejtave të fëmijës;

c) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të cilat japin kontribut në fushën e të drejtave të fëmijës;

d) drejtues të strukturave përkatëse në ministritë përgjegjëse/ekspertë të administratës publike, në varësi të çështjeve që do të diskutohen;

e) nëpunësit që merren me çështjet e të drejtave të fëmijës në ministri dhe organe të qeverisjes vendore;

f) ekspertë të çështjeve të të drejtave të fëmijës, si dhe;

g) ekspertë të tjerë të fushave të ndryshme.

2. Pjesëmarrësit e ftuar në mbledhjet e Këshillit, marrin pjesë nëse:

a) ministri që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës e vlerëson si të nevojshme dhe të domosdoshme këtë;

b) kërkohet paraprakisht nga anëtarët e Këshillit;

c) kërkohet nga drejtuesi/ja i/e strukturës politikbërëse për çështjet e të drejtave të fëmijës në ministri;

ç) kanë paraqitur në mbledhjen e mëparshme një kërkesë për këtë qëllim, dhe Këshilli ka marrë vendim për këtë çështje.

3. Gjatë mbledhjes së Këshillit në të cilën marrin pjesë, ata mund të ftohen të japin shpjegime dhe sqarime për çështjet që diskutohen, nëse kjo kërkohet nga anëtarët e Këshillit.

Neni 7

Rregulli i mbledhjes së Këshillit

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës mblidhet jo më pak se 2 herë në vit, në varësi të problematikës që kërkon të shqyrtohet në këtë Këshill.

Neni 8

Thirrja e mbledhjes së Këshillit

1. Thirrja e mbledhjes së Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës bëhet nga Kryetari, i cili vendos për datën, kohën dhe vendin e mbledhjes së radhës.

2. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje edhe kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

3. Njoftimi për mbledhjen e radhës bëhet jo më vonë se 15 ditë para nga data kur do të zhvillohet mbledhja.

4. Njoftimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

5. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtari/e të Këshillit, 5 ditë para mbledhjes, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.

Neni 9

Rendi i ditës

1. Kryetari i Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë çështje:

a) që i janë propozuar atij nga anëtarët e Këshillit me të drejtë vote, nga drejtuesi/ja e strukturës politikbërëse që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmijës, apo shoqërinë civile që kanë veprimtari në këtë fushë, si dhe;

b) që janë në kompetencë të Këshillit sipas nenit 12 të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

2. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 7 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen.

3. Rendi i ditës duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve, jo më vonë se 15 ditë para nga data kur do të zhvillohet mbledhja, dhe të paktën 7 ditë para datës së thirrjes të mbledhjes. Bashkëngjitur rendit të ditës, anëtarëve iu shpërndahen edhe materialet që do të diskutohen në mbledhje.

Neni 10
Kuorumi

1. Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është e vlefshme kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të tij.

2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, Kryetari/ja vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 7 ditë pas të parës. Në këtë rast, mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 11
Marrja e vendimeve

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës merr vendime vetëm për çështje, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 12
Shumica e nevojshme për të marrë vendime

1. Vendimet për çështjet që diskutohen në Këshill merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe që kanë të drejtën e votës.

2. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e Kryetarit/es është vendimtare.

Neni 13
Forma e votimit

Vendimet në Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës merren me votim të hapur.

Neni 14
Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

2. Procesverbali mbahet nga sekretariati i Këshillit dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryetari/ja e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

3. Në rastet kur vetë Këshilli e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.

Neni 15
Përfshirja në procesverbal e votave "kundër"

1. Anëtarët e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga ky Këshill.

2. Në rastet kur vendimet e Këshillit do t'i dërgohen një organi më të lartë të administratës, këto vendime do të shoqërohen me deklarimet e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Neni 16
Sekretariati i Këshillit

1. Për realizimin e funksioneve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, sekretariati i Këshillit:

a) përgatit ose koordinon hartimin e materialeve, me institucionet dhe strukturat përgjegjëse për çështjet që do të diskutohen në mbledhjen e Këshillit;

b) siguron dorëzimin e materialeve tek anëtarët e Këshillit, në afatet e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës përbëhet nga punonjës të strukturës politikbërëse që bashkërendon çështjet e të drejtave të fëmiijës në ministrinë e kësaj fushe.

Neni 17
Ngritja e funksionimi i komiteteve teknike këshilluese

1. Pranë KKMDF-së do të krijohen dhe funksionojnë komitetet teknike këshilluese, si më poshtë vijojnë:

a) komiteti i mbrojtjes sociale;

b) komiteti i drejtësisë së të miturve;

c) komiteti i të drejtës për arsim;

ç) komiteti për çështjet e trafikimit të fëmijëve;

d) komiteti i të drejtës për kujdes shëndetësor;

e) komiteti i të drejtave për aktivitete kulturore argëtuese.

2. Komitetet teknike këshilluese kanë për objekt të shqyrtojnë çështje për fushat e tyre të kompetencës dhe të transmetojnë mendimet dhe përfundimet e këshillimeve të KKMDF-së, për:

a) orientimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushat e veprimtarisë së tyre;

b) projektaktet ligjore dhe nënligjore që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre;

c) çështjet për të cilat KKMDF-ja iu është drejtuar atyre për konsultim dhe mendim;

d) raporte për zbatueshmërinë e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

3. Për arritjen e objektivave, çdo komitet mund të angazhojë specialistë të kualifikuar të fushës.

4. Komitetet teknike këshilluese kryesohen nga kryetari dhe kanë në përbërje jo më pak se 8 anëtarë. Përbërja e tyre përcaktohet nga KKMDF-ja.

5. Kryetarët e komiteteve teknike këshilluese caktohen nga ministri përgjegjës për çështjet që këshillohen në komitet, brenda administratës së kësaj ministrie, në nivelin e drejtorit të drejtorisë, sipas fushave që ata mbulojnë. Anëtarët e komiteteve, përfaqësues të institucioneve shtetërore, caktohen nga titullarët e tyre.

6. Secili komitet teknik këshillues ka sekretarinë e tij, që e mbulon institucioni apo drejtoria përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet që këshillohen në komitet.

7. Komiteti teknik këshillues në përfundim të çdo mbledhjeje përgatit relacionin për çështjet e konsultuara, të cilin ia përcjell ministrit që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

VENDIM
Nr.207, datë 9.3.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË POLIÇAN TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Poliçan të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 31 (tridhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 88 (tetëdhjetë e tetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Poliçan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Poliçan Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-2	Varreza publike	Në pronësi
3, 4, 6-11	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
13-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
23	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
25-26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore dhe sportive	Në pronësi
68	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
69-72	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim SAMT ka vënë në dispozicion të AKKP-së sipërfaqen prej 226.6 ha tokë bujqësore, në zonën kadastrale 3019
73, 84-88	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
75	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

77, 12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
78-83	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr.208, datë 9.3.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS VLLAHINË TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Vllahinë të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Vllahinë, të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.1683, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Vllahinë, të qarkut të Vlorës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Vllahinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Vllahinë Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
5-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
11-32	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
33-50,51-55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
56-71	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
72-235	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën: sheshe të lira	Në pronësi
236-248,310	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (truall)	Në pronësi

249,250,252,253,254, 256,257,258,259,261, 262,263,264,266,267, 269,270,271,272,274, 275,276,277,278,279, 280,281,283,284,285, 287,288,289,291,292, 293,294	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën: bujqësi dhe ushqim (tokë bujqësore produktive). Sip.122.28 ha, zona kadastrale 3801 fshati Vllahinë dhe sip.72.19 ha, zona kadastrale 2941, fshati Petë i janë dorëzuar AKKP-së	Në përdorim
251,255,260,265,268, 273,277,282,286,290 295,316-338	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën: bujqësi, ushqim (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
339-743	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve: infrastrukturë rrugore (rrugë, kanal)	Në pronësi
750-768	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve: ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.210, datë 16.3.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KËRRABË TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kërrabë të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 46 (dyzet e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 264 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kërrabë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kërrabë Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
72	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative	Në pronësi
75-79	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
80, 81	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
82-92	Prona që përdoren për realizimin e programeve social-kulturore e sportive	Në pronësi
93-209	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
210-214	Varrezat publike	Në pronësi
217-241	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
243-254	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip.15 ha, zona kadastrale 3471, fshati Skuterrë i është dorëzuar AKKP-së	Në përdorim
255, 256	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.211, datë 16.3.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SLLOVË TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Sllovë të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Sllovë të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.479, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Sllovë të qarkut të Dibrës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Sllovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-17	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
18-27	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
28-30	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
31-40, 224-375	Infrastrukturë vendore (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
391-394	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip.22 ha në fshatin Sllatinë, sip.68 ha në fshatin Shumbat dhe sip.29 ha në fshatin Sllovë i janë dorëzuar AKKP-së	Në përdorim
395, 396	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr.212, datë 16.3.2011

PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.107, DATË 10.2.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për arsimin parauniversitar", të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërve", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ky ndryshim:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU) dhe shtëpi të tjera botuese ngarkohen me botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të pakicave kombëtare, të klasave I deri IX, dhe të teksteve të arsimit profesional. Shtypja e këtyre teksteve të realizohet në SHBLU dhe në shtypshkronja të tjera.

Çmimi i këtyre teksteve miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Mënyra e shpërndarjes së tyre përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.".

b) Pika 6.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6.4. Për tekstet shkollore të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, dhe për tekstet shkollore të fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, çmimi i blerjes të mbulohet në masën 100 për qind, me fondet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.”.

c) Pas pikës 6.4 shtohen pikat 6.5, 6.6, 6.7 dhe 6.8, me këtë përmbajtje:

“6.5. Për tekstet shkollore të fëmijëve të familjeve të emigrantëve, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedura e blerjes së tyre realizohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kundrejt procedurave të konkurrimit të hapur me shtëpitë botuese. Procesi i botimit, i shtypjes, i shpërndarjes dhe i shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese.

6.6. Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me selitë diplomatike në këto vende, dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, brenda muajit maj të çdo viti, kërkesën për tekste shkollore, të detajuar sipas grup-moshave të fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dërgon në Ministrinë e Punëve të Jashtme, brenda muajit gusht të çdo viti, sasinë e teksteve shkollore të porositura.

6.7. Për tekstet shkollore të fëmijëve romë, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës romë, duhet të dorëzojnë në DAR/ZA-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6.8. Nxënësit që gëzojnë statusin e të verbrit, të cilët mësojnë në klasat I deri IX, pajisen me tekste shkollore të transkriptuara në shkrimin brail, të regjistruara në audio ose në shkrim të zmadhuar. Çmimi i blerjes së këtyre teksteve të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Këto tekste shkollore janë pronë e shkollës dhe afati i përdorimit të tyre mund të variojë nga dy deri në tre vjet.”.

ç) Pas pikës 8 shtohet pikat 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e teksteve në brail dhe në shkrim të zmadhuar literal, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër të realizohen nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës të verbër, duhet të dorëzojnë në DAR/ZA-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.213, datë 16.3.2011

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS, TOKË BUJQËSORE, TË NDODHUR NË ISH-NDËRMARRJEN BUJQËSORE, SPITALLË, DURRËS, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS, PËR NDËRTIMIN E NJË KAMPUSI TË RI UNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 82, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës së regjistruar, si tokë bujqësore, e ndodhur në zonën kadastrale nr.8517, në parcelat nr.78 a, 79 a, 80 a dhe 81 a, me një sipërfaqe të përgjithshme 55.65 (pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e pesë) ha, në ish-Ndërmarrjen Bujqësore, Spitallë Durrës, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për nevojat e universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, për ndërtimin e kampusit të ri universitar.
2. Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, pas marrjes në përdorim të pronës së përcaktuar në këtë vendim, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
3. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.22, datë 10.3.2011

PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT TË ERE-S NR.10, DATË 18.2.2011

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi shkresat e paraqitura nga shoqëritë "CEZ shpërndarje" sh.a. dhe KESH sh.a. mbi kthimin e shoqërisë "Albanian Chrome" sh.p.k., për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor,

konstatoi se:

- "CEZ shpërndarje" sh.a. konfirmon se është i gatshëm t'i ofrojë shërbimin e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike shoqërisë ACR sh.p.k., duke filluar nga 15 marsi 2011, por pa përmendur kostot që mbart në vetvete ky kthim dhe marrjen përsipër të tyre.

- “CEZ shpërndarje” sh.a. pretendon që kostot shtesë që shkaktohen nga furnizimi me energji elektrike të shoqërisë “Albanian Chrome” sh.p.k. të mos i paguajë as “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe as kompania që përfiton statusin e ri, por ato të axhustohen përmes tarifës së furnizimit publik me shumicë duke e transferuar te subjektet e tjera pjesëmarrëse në tregun e energjisë, gjë që bie ndesh me modelin shqiptar të tregut të energjisë elektrike (pika 7, germa “a”) dhe rregullat e tregut shqiptar të energjisë (pika IV.2).

- KESH sh.a., me shkresën nr.1289 prot., datë 8.3.2011, rideklaron se kthimi i klientit të kualifikuar “Albanian Chrome” sh.p.k. në klient tarifor sjell pashmangshmërisht rritjen e kërkesës së “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe detyrimisht kosto shtesë për KESH sh.a. KESH-i, kërkon nga ERE, që në rast kthimi të “Albanian Chrome” sh.p.k., në klient tarifor, kostot shtesë t’u ngarkohen këtyre subjekteve në bazë të modelit dhe rregullave të tregut të energjisë elektrike.

- Përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë ACR sh.p.k. shprehen dakord me përmbajtjen e relacionit të paraqitur në mbledhjen e Bordit të Komisionerëve dhe kërkuan të jetë në diskrecionin e tyre për të vendosur nëse do ta ushtrojnë të drejtën për t’u kthyer në statusin e klientit tarifor ose jo.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Subjekti “Albanian Chrome” sh.p.k., lejohet të kthehet nga klient i kualifikuar në klient tarifor, duke filluar nga data 15 mars 2011, duke mbuluar të gjitha kostot shtesë të shkaktuara ndaj KESH sh.a. në funksionin e tij si furnizues publik me shumicë.

2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarje” sh.a. te subjekti “Albanian Chrome” sh.p.k., për periudhën nga bërja efektiv e statusit të klientit tarifor deri në datën 31 dhjetor 2011, do të jetë 14.55 lekë/kWh.

3. Me bërjen efektive të statusit të klientit tarifor nga ACR sh.p.k., “CEZ shpërndarje” sh.a. do t’i paguajë çdo muaj shoqërisë KESH sh.a., diferencën ndërmjet çmimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe tarifës përkatëse të kategorisë së klientëve tariforë, ku përfshihet “Albanian Chrome” sh.p.k., të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.100, datë 7.12.2010 (14.55 lekë/kWh – 7.62 lekë/kWh të barabartë me 6.93 lekë për çdo kWh, të faturuar klientit “Albanian Chrome”).

4. ACR sh.p.k. të vendosë për statusin përfundimtar brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. ACR sh.p.k. të njoftojë “CEZ shpërndarjen” dhe ERE-n 5 ditë para ditës së bërjes efektive të satusit të klientit tarifor.

6. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë “Albanian Chrome” sh.p.k., “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe KESH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.23, datë 10.3.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC – VLUSHE" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13, pika 1 germa "a", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa "a", nenit 5, pika 1 germa "a", neneve 13 dhe 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hec – Vlushe" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec – Vlushe" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec – Vlushe" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec – Vlushe", me kapacitet 14.2 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.24, datë 10.3.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC - VLUSHE" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13, pika 1 germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa "g", nenit 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Hec - Vlushe" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec - Vlushe" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec-Vlushe" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.25, datë 10.3.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC DRAGOSHTUNJË" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5 pika 1 germa "a", dhe neneve 13 e 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hec Dragoshtunjë" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Dragoshtunjë" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec Dragoshtunjë" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et "Zanore" me fuqi 1.2 MW, "Dragoshtunjë" me fuqi 3.1 MW, "Hotolisht" me fuqi 1.6 MW dhe "Ura" me fuqi 0.8 MW, për një periudhë 30-vjeçare.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.26, datë 10.3.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC DRAGOSHTUNJË" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13, pikat 1 germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "g", nenit 5, pika 1 germa "g", dhe neneve 13 dhe 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "hec Dragoshtunjë" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Dragoshtunjë" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec Dragoshtunjë" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.27, datë 10.3.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC DUNICË" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pika 1, germa "a", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa "a", nenit 5, pika 1 germa "a" dhe neneve 13 e 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hec Dunicë" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Dunicë" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "Hec Dunicë" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et "Trebinjë" me fuqi 0.39 MW, "Potgozhan" me fuqi 0.692 MW, "Kalivaç" me fuqi 0.73 MW, "Dunicë 1" me fuqi 0.68 MW, "Dunicë 2" me fuqi 0.75 MW, për një periudhë 30-vjeçare.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.28, datë 10.3.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC DUNICË" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13, pikat 1 germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa "g", nenit 5 pika 1 germa "g", dhe neneve 13 e 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave ", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Hec Dunicë" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Dunicë" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "Hec Dunicë" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
(*i shkurtuar*)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.820, datë 9.2.2011, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhiat Hoxha, i biri i Pajazitit, i datëlindjes 17.5.1958, lindur në Strugë, Jugosllavi, dhe caktimin e bashkëshortes së tij, shtetases Enkeleda Hoxha si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 15.4.2011
Doli nga shtypi më 17.4.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 44 lekë